Raporti i garës Šalamunov Memorial 2026

Nga 8 deri më 13 qershor 2026, Federata e Gjimnastikës e Kosovës mori pjesë në garën tradicionale ndërkombëtare Šalamunov Memorial 2026, e mbajtur në Maribor të Sllovenisë. Në këtë edicion morën pjesë rreth 200 gjimnastë nga dhjetëra vende evropiane. Gara mblodhi klube të shumta dhe gjashtë ekipe kombëtare: Sllovenine, Belgjikën, Kroacinë, Irlandën, Poloninë dhe Kosovën, duke e bërë edhe këtë vit një nga garat më cilësore ndërkombëtare.

Delegacioni i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës përbëhej nga:

- Doruntinë Ibrahimi – Trajnere
- Arlind Shaqiri – Trajner
- Elmira Gërguri – Fizioterapeute
- Sara Pllana – Gjimnaste
- Rea Berisha – Gjimnaste
- Fernaze Cakaj – Gjimnaste
- Hira Haziri – Gjimnaste
- Borë Krasniqi – Gjimnaste

Federata pritëse (host federation) ishte Slovenian Gymnastics Federation, ndërsa komiteti organizativ i garës ishte Društvo za šport in rekreacijo Železničar Maribor.

Lokacioni i garës**:** Sports Hall Tabor (Dvorana Tabor), Koresova ulica 7, 2000 Maribor, Slovenia
Hoteli ku qëndroi ekipi i Kosovës: Hotel Tabor Maribor

➢ HOTEL TABOR MARIBOR, Ulica heroja Zidanška 18, 2000 Maribor



Dita e pare - 8 qershor 2026

Ekipi u nis nga Prishtina në orën 01:00 pas mesnate drejt Aeroportit të Shkupit. Fluturimi me kompaninë Croatia Airlines ishte i planifikuar në orën 05:20 drejt Zagrebit. Pas mbërritjes në Zagreb, delegacioni vazhdoi udhëtimin me taksi drejt Mariborit, ku mbërriti rreth orës 07:00.

Pas mbërritjes në hotel, ekipi priti orarin e check-in, i cili filloi në orën 12:00. Në mbrëmje u zhvillua stërvitja e parë zyrtare nga ora 18:00 deri në 20:00, ndërsa më pas delegacioni mori pjesë në darkën e organizuar nga organizatori.

Dita e dytë - 9 qershor 2026

Gjatë kësaj dite gjimnastet zhvilluan stërvitjen zyrtare në sallën e garës sipas orarit të dhënë në planin e punës. Stërvitja u shfrytëzua për përshtatjen me pajisjet dhe ambientin e garës, si dhe për përgatitjet për paraqitjet kualifikuese.

Pas përfundimit të stërvitjes u mbajt edhe mbledhja teknike e organizatorëve me delegacionet pjesëmarrëse, ku u dhanë udhëzimet për zhvillimin e garës.

Dita e tretë - 10 qershor 2026

Në këtë ditë garuan gjimnastet e kategorisë Youth.

Hira Haziri, Fernaze Cakaj dhe Borë Krasniqi përfaqësuan Kosovën me paraqitje të mira në disiplinat e tyre.

Gjatë ushtrimit në parter, Fernaze Cakaj pësoi një lëndim të lehtë gjatë elementit Double Back, për çka u detyrua të ndërpresë garën. Fatmirësisht lëndimi nuk rezultoi serioz dhe me trajtimin e menjëhershëm të fizioterapeutes Elmira Gërguri gjendja e saj u stabilizua shpejt.

Hira Haziri realizoi një paraqitje shumë të mirë në shumëgarësh, duke treguar progres të dukshëm në krahasim me garat e mëparshme ndërkombëtare.

Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Rezultatet:

15	**Jade Lelievre-Damit**	ASBL Gymnos Charleroi	BEL	Final 10.400 D 1.6 P 0.0 E 8.800	Final 9.150 D 1.0 P 0.0 E 8.150	Final 10.800 D 3.4 P 0.0 E 7.400	Final 10.566 D 2.8 P 0.0 E 7.766	**40.916**
16	**Hana Kostov**	ŠD Center Maribor	SLO	Final 11.933 D 3.2 P 0.0 E 8.733	Final 8.650 D 1.0 P 0.0 E 7.650	Final 10.050 D 3.5 P 0.0 E 6.550	Final 10.066 D 2.9 P 0.0 E 7.166	**40.699**
17	**Hira Haziri**	Kosova Gymnastics Federation	KOS	Final 10.633 D 2.0 P 0.0 E 8.633	Final 8.150 D 0.8 P 0.0 E 7.350	Final 11.150 D 4.0 P 0.0 E 7.150	Final 10.533 D 3.2 P 0.0 E 7.333	**40.466**
18	**Soline D'Hondt**	Europa Gym	BEL	Final 10.900 D 3.2 P 0.0 E 7.700	Final 7.900 D 1.0 P 0.0 E 6.900	Final 11.000 D 3.0 P 0.0 E 8.000	Final 10.633 D 3.3 P 0.0 E 7.333	**40.433**
19	**Alya Preat**	ASBL Gymnos Charleroi	BEL	Final 10.633 D 1.6 P 0.0 E 9.033	Final 9.050 D 0.9 P 0.0 E 8.150	Final 9.850 D 3.0 P 0.0 E 6.850	Final 10.666 D 2.7 P 0.0 E 7.966	**40.199**
20	**Maya Cielen**	Gymfed	BEL	Final 12.366 D 3.4 P 0.0 E 8.966	Final 9.400 D 1.2 P 0.0 E 8.200	Final 9.150 D 3.8 P 0.0 E 5.350	Final 9.266 D 2.8 P 0.0 E 6.466	**40.182**
21	**Bruna Pappo**	Gimnastički klub Dubrava	CRO	Final 11.000 D 2.6 P 0.0 E 8.400	Final 8.200 D 0.8 P 0.0 E 7.400	Final 10.450 D 3.5 P 0.0 E 6.950	Final 10.466 D 3.4 P 0.0 E 7.066	**40.116**
67	**Neja Cehner**	ŠD Center Maribor	SLO	Final 10.400 D 1.6 P 0.0 E 8.800	Final 8.200 D 0.8 P 0.0 E 7.400	Final 7.000 D 3.1 P 0.0 E 3.900	Final 9.166 D 2.1 P 0.0 E 7.066	**34.766**
68	**Miša Cigale**	GŠ Celje	SLO	Final 11.066 D 2.4 P 0.0 E 8.666	Final 7.550 D 0.7 P 0.0 E 6.850	Final 6.700 D 2.0 P 0.0 E 4.700	Final 9.400 D 2.4 P 0.0 E 7.000	**34.716**
69	**Bore Krasniqi**	Kosova Gymnastics Federation	KOS	Final 10.400 D 1.6 P 0.0 E 8.800	Final 6.550 D 0.6 P 0.0 E 5.950	Final 7.650 D 2.0 P 0.0 E 5.650	Final 9.666 D 2.6 P 0.0 E 7.066	**34.266**
70	**Liepa Zaikauskaité**	Elektrėnų Savivaldybės Sporto Centras	LTU	Final 11.500 D 3.2 P 0.0 E 8.300	Final 7.550 D 1.0 P 0.0 E 6.550	Final 8.100 D 3.3 P 0.0 E 4.800	Final 7.066 D 3.1 P 0.3 E 4.266	**34.216**
87	**Eva Belovec**	GD Divača	SLO			Final 4.650 D 1.4 P 1.0 E 4.250	Final 6.000 D 0.5 P 0.5 E 6.000	**10.650**
88	**Floor Demey**	Gymfed	BEL		Final 8.100 D 2.6 P 0.0 E 5.500			**8.100**
	Fernaze Cakaj	Kosova Gymnastics Federation	KOS	Final DNS	Final DNS	Final 10.500 D 3.8 P 0.0 E 6.700	Final 7.733 D 2.2 P 0.0 E 5.533	**18.233**

Në ora 18:00 kishin ushtrime kategoria Juniore, përkatësisht gjimnastjet Sara Pllana dhe Rea Berisha.

Dita e katërt - 11 qershor 2026

Në këtë ditë u zhvilluan garat e kategorisë Junior, ku Kosovën e përfaqësuan Sara Pllana dhe Rea Berisha.

Të dyja gjimnastet zhvilluan paraqitje të mira, ndërsa Sara Pllana arriti të sigurojë kualifikimin në finalet e dy disiplinave, traut dhe kapërcimeve, duke vazhduar garën edhe në ditën finale të garës.

Rank	Name	Club	Country					Total
14	**Sara Pllana**	Kosova Gymnastics Federation	KOS	Final 12.000 V1 12.000 V2 11.900	Final 7.466 D 1.0 P 0.0 E 6.466	Final 11.700 D 4.5 P 0.0 E 7.200	Final 10.033 D 4.5 P 0.0 E 5.533	**41.199**
15	**Lilou Gustin**	Gymfed	BEL	Final 12.166 V1 12.166 V2 11.533	Final 8.666 D 1.2 P 0.0 E 7.466	Final 9.833 D 3.3 P 0.0 E 6.533	Final 10.466 D 2.8 P 0.1 E 7.766	**41.131**
16	**Lena Marciniak**	KS Ewo Gim Katowice	POL	Final 10.300 V1 10.300 V2 DNS	Final 10.233 D 2.4 P 0.0 E 7.833	Final 10.566 D 4.2 P 0.0 E 6.366	Final 10.000 D 3.0 P 0.0 E 7.000	**41.099**
17	**Ana Matzele Golob**	Gimnastična zveza Slovenije	SLO	Final 11.300 V1 11.300 V2 DNS	Final 7.200 D 1.5 P 0.0 E 5.700	Final 11.100 D 3.2 P 0.0 E 7.900	Final 10.933 D 3.5 P 0.0 E 7.433	**40.533**
	Rea Berisha	Kosova Gymnastics Federation	KOS	Final DNS V1 DNS V2 DNS	Final 5.300 D 0.7 P 0.0 E 4.600	Final 10.066 D 3.4 P 0.1 E 6.766	Final DNS	**15.366**
	Giulia Asaftei	Polski Związek Gimnastyczny	POL	Final 12.800 V1 12.800 V2 12.633	Final DNS	Final DNS	Final DNS	**12.800**
	Maja Brusik	Polski Związek Gimnastyczny	POL	Final DNS V1 DNS V2 DNS	Final 10.666 D 3.3 P 0.0 E 7.366	Final DNS	Final DNS	**10.666**
	Lotta Kalinski	Croatian Gymnastics Federation	CRO	Final DNS V1 DNS V2 DNS	Final DNS	Final DNS	Final DNS	**DNF**

Dita e pestë - 12 qershor 2026

Gjatë kësaj dite nuk pati paraqitje të ekipit të Kosovës në garë. Gjimnastet zhvilluan stërvitje të lehtë dhe përgatitje për finalet e ditës së nesërme.

Në këtë ditë ekipi bëri vizitë në qytetin e Mariborit.

Në mbrëmje delegacioni mori pjesë në darkën zyrtare (Banquet) të organizuar nga organizatori, së bashku me ekipet pjesëmarrëse nga vendet e tjera.

Dita e gjashtë -13 qershor 2026

Në ditën e fundit të garës u zhvilluan finalet nëpër vegla.

Sara Pllana garoi në finalen e kapërcimeve dhe arriti një sukses shumë të madh duke fituar **medaljen e argjendtë**, rezultat ky që përbën edhe suksesin më të madh të delegacionit kosovar në këtë edicion të garës.

Po ashtu, Sara garoi edhe në finalen e traut. Pavarësisht një rrëzimi gjatë hyrjes në ushtrim, ajo realizoi një performancë shumë cilësore dhe u rendit në vendin e katërt me 11.350 pikë, duke mbetur shumë pranë medaljes.

Balance Beam

57 ŠALAMUNOV MEMORIAL 2026 FINALS
INTERNATIONAL COMPETITION
JUNIORS

Rank	Name	Club	Country	D	P	E	Total
1	VOLKOFF Estella	Ireland	IRL	5.1	0.0	7.800	12.900
2	HICKEY Roisin	Ireland	IRL	4.6	0.0	7.600	12.200
3	KUPKA Alicja	MKS Pałac Młodzieży - Katowice	POL	4.4	0.0	7.600	12.000
4	PLLANA Sara	Kosova Gymnastics Federation	KOS	4.5	0.0	6.850	11.350
5	MARCINIAK Lena	KS Ewo Gim Katowice	POL	4.4	0.0	6.850	11.250
6	MATZELE GOLOB Ana	Gimnastična zveza Slovenije	SLO	3.2	0.0	7.250	10.450
7	HOJS RAKIĆ Arya	Gimnastična zveza Slovenije	SLO	4.5	0.0	5.750	10.250
8	JEVĐENIĆ Taša	ŠD Studenci	SLO	4.1	0.0	5.550	9.650
9	OŠTARČEVIĆ Eva	Croatian Gymnastics Federation	CRO	4.2	0.0	5.450	9.650

Vault

Final Score Is Average Of Two Vaults

57 ŠALAMUNOV MEMORIAL 2026 FINALS
INTERNATIONAL COMPETITION
JUNIORS

Rank	Name	Club	Country	V	D	P	E	Vault 1 Vault 2	Vault bonus	Total
1	ASAFTEI Giulia	Polski Związek Gimnastyczny	POL	V1 V2	4.2 3.2	0.0 0.0	8.900 8.600	13.100 11.800	0.0	12.450
2	PLLANA Sara	Kosova Gymnastics Federation	KOS	V1 V2	3.4 3.2	0.0 0.0	8.700 8.700	12.100 11.900	0.0	12.000
3	TOMAŽIČ Živa	Gimnastična zveza Slovenije	SLO	V1 V2	3.2 3.0	0.0 0.0	8.900 8.750	12.100 11.750	0.0	11.925
4	HENSITSKA Anna	Allgemeiner Turnverein Graz	AUT	V1 V2	3.4 3.6	0.0 0.0	8.700 8.150	12.100 11.750	0.0	11.925
5	OŠTARČEVIĆ Eva	Croatian Gymnastics Federation	CRO	V1 V2	3.4 3.2	0.0 0.0	8.450 8.200	11.850 11.400	0.0	11.625
6	BRGLEZ Hana	ŠD Studenci	SLO	V1 V2	3.4 3.2	0.0 0.0	8.350 8.300	11.750 11.500	0.0	11.625
7	GUSTIN Lilou	Gymfed	BEL	V1 V2	3.4 3.2	0.0 0.0	8.400 8.200	11.800 11.400	0.0	11.600
8	FLERES Ninon	Gymfed	BEL	V1 V2	3.4 3.2	0.0 0.0	7.550 7.750	10.950 10.950	0.0	10.950
9	KELLY Lauren	Ireland	IRL	V1 V2	3.0 3.2	0.0 0.0	7.950 7.450	10.950 10.650	0.0	10.800

Pas përfundimit të ceremonive të ndarjes së medaljeve, delegacioni u nis nga Maribori drejt Aeroportit të Zagrebit në orën 18:00, me taxi/kombi.

Fluturimi nga Zagrebi për në Shkup ishte planifikuar për në orën 22:00, mirëpo fillimisht u shty dhe më pas u anulua. Kompania Croatia Airlines siguroi akomodimin e delegacionit në hotel dhe organizoi fluturimin zëvendësues për ditën e nesërme me date 14 qershor në orën 14:00.

Pas mbërritjes në Aeroportin e Shkupit, autobusi i organizuar priti delegacionin në orën 15:30 dhe udhëtimi drejt Prishtinës përfundoi rreth orës 18:00.

Përfundim

Federata e Gjimnastikës e Kosovës e përfundoi me sukses pjesëmarrjen në garën ndërkombëtare Šalamunov Memorial 2026, duke fituar medaljen e argjendtë në disiplinën e kapërcimeve me gjimnasten Sara Pllana. Po aq inkurajuese ishte edhe paraqitja e Sarës në finalen e traut, ku pavarësisht një gabimi në fillim të ushtrimit arriti të renditet në vendin e katërt. Gjithashtu, paraqitjet e Hira Hazirit, Rea Berishës, Borë Krasniqit dhe Fernaze Cakajt ishin të mira.

Vlen të theksohet edhe kontributi i madh i trajnerëvev Doruntinë Ibrahimi dhe Arlind Shaqiri dhe i fizioterapeutes Elmira Gërguri, e cila gjatë gjithë garës u kujdes për rikuperimin dhe gjendjen fizike të sportisteve.

Pjesëmarrja në këtë garë ishte një përvojë shumë e vlefshme për ekipin kombëtar dhe një hap tjetër drejt përgatitjeve për garat e ardhshme ndërkombëtare.

Disa foto nga aktiviteti:





FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION









FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION



Rezultatet e plota të garës mund të gjenden në linkun:
https://www.salamunov-memorial.si/sl-si/

Data e raportit: 29.06.2026
Prishtinë